

VENDIM
Nr. 63, datë 8.4.2020

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “GEGA-G” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “PREVALLI”, ME KAPACITET
TË INSTALUAR 1750 kw**

(ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 207, datë 27.6.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2 germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, të nenit 5, pika 1, germa “a” dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; dhe të nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.4.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 26, datë 10.2.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Prevalli”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në medien e shkruar, me shkresën nr. 62/8, datë 11.2.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “GEGA-G” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 502 prot., datë 17.2.2020, ERE iu drejtua shoqërisë, duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “GEGA-G” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 502/1 prot., datë 25.2.2020, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “GEGA-G” sh.p.k. është regjistruar pranë QKB-së në datën 24.8.2001, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

- Shoqëria “GEGA-G” sh.p.k. është themeluar përpara nënshkrimit të kontratës me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe kjo e fundit e ka njohur shoqërinë si mbajtësen e miratimit. Kontrata nr. 2784 rep. dhe nr. 1308/2 kol., datë 14.12.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Prevalli’, me kapacitet prodhues 1.750 mw, në përroin e Zallit të Kostenjës, degë e Zallit të Lunikut, me derdhje në lumin Shkumbin, fshati Prevalli, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan”, është lidhur për një afat 49-vjeçar, që fillon nga data e hyrjes në fuqi të saj, me të drejtë ripërsëritjeje.

- Parametrat e sipërcituar janë të njëjtë me ata të pasqyruar në “Raportin e oponencës teknike” dhe kontratën me MIE-n, nr. 2784 rep. dhe nr. 1308/2 kol., datë 14.12.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Prevalli’, me kapacitet prodhues 1.750 mw, në përroin e Zallit të Kostenjës, degë e Zallit të Lunikut, me derdhje në lumin Shkumbin, fshati Prevalli, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan”.

- Shoqëria ka depozituar në ERE kontratën nr. 8582 prot., datë 4.10.2017, “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor kullor publik, ndërtim dhe shfrytëzim i HEC ‘Prevalli’, lidhur midis Bashkisë Librazhd dhe shoqërisë ‘GEGA-G’ sh.p.k.”. Kjo kontratë ka në objektin e saj dhënien me qira të fondit pyjor kullor për përdorim sipërfaqen 0.036 ha; për ndërtimin e bazamentit të shtyllave të tensionit 3.59 km; për shtrirjen e tubacioneve të HEC-it 5.53 km. Qëllimi i kontratës është ushtrimi i veprimtarisë së ndërtimit të HEC “Prevalli”, për prodhim energjie. Kjo kontratë lidhet për një afat 10-

vjeçar, duke filluar nga data 4.10.2017 deri në datën 4.10.2027, me të drejtë rinovimi, në zbatim të legjislacionit në fuqi, duke njoftuar njëra-tjetrën 3 muaj para përfundimit të afatit për rinovimin e saj.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE, “Miratim ndryshimi, pikë lidhjeje, HEC ‘Prevall’ për shoqërinë ‘GEGA-G’ sh.p.k.”. Ky miratim është dhënë për kapacitetin e instaluar prej 1750 kw.

- Shoqëria ka paraqitur leje “Për përdorimin të burimit ujqor” nr. 61/2 prot., datë 16.10.2017, miratuar me vendimin nr. 55, datë 10.10.2017, “Për miratimin e lejes së përdorimit të burimit ujqor të përroit të Zallit të Kostenjës, degë e lumit Shkumbin, për prodhim hidroenergjie, shoqërisë ‘GEGA-G’ sh.p.k.”. Kjo leje është dhënë për një afat 5 vjeçar dhe është e vlefshme deri në datën 16.12.2022.

- Shoqëria ka depozituar në ERE, VNM-në paraprake nr. 1772 prot., datë 24.7.2017, miratuar me vendimin nr. 30 dhe nr. 532 identifikimi, lëshuar për shoqërinë “GEGA-G” sh.p.k., për të zhvilluar projektin e HEC “Prevall”.

- Sipas analizës financiare, financimi i veprës parashikohet të bëhet 80% me kredi bankare, me afat shlyerje 10 vjet dhe 20% me burimet e të ardhurave të vetë shoqërisë.

- Shoqëria ka depozituar në ERE kontratën nr. 8582 prot., datë 4.10.2017, “Për dhënien në përdorim të fondit pyjqor kullosor publik, ndërtim dhe shfrytëzimi i HEC ‘Prevall’”, lidhur midis Bashkisë Librazhd dhe shoqërisë “GEGA-G” sh.p.k. Kjo kontratë lidhet për një afat 10-vjeçar, duke filluar nga data 4.10.2017 deri në datën 4.10.2027, me të drejtë rinovimi, në zbatim të legjislacionit në fuqi, duke njoftuar njëra-tjetrën 3 muaj para përfundimit të afatit për rinovimin e saj.

Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “GEGA-G” sh.p.k., rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, ghermat “a”, “b”, “c”: plotësuar;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, ghermat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”: plotësuar;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, ghermat “a”, “b”, “c”, “d”: plotësuar;
- dokumentacioni teknik për HEC-in, neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, ghermat “a”, “b”, “c”, “d” dhe pika 4.1.4, ghermat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”: plotësuar;
- lejen nga institucionet e tjera, neni 9, pika 4.1.5, ghermat “a”, “b”, “c”: plotësuar.

ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe të nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të gjatë se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “GEGA-G” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Prevall”, me kapacitet të instaluar 1750 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria “Gega-G” sh.p.k. të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë të lidhur me Bashkinë Librazhd brenda datës 4.10.2027, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në territorin ku shtrihet projekti i HEC “Prevall”.

3. Shoqëria “GEGA-G” sh.p.k. të depozitojë në ERE lejen e rinovuar për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC Prevall jo më vonë se data 6.10.2027.

4. Shfuqizuar.

5. Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti